

Hylli i Dritës

Ubi Spiritus Domini, ibi libertas.

(II. ad Cor. III. 17).

1. Kuptimi shkolluer ndër Kombe të qytetnueme	Fq. 201
2. Kuptimi shkolluer në Shtetin e lirë konstitucjonal-afetár të Shqypnis	„ 214
3. Si i menduen shkrimtarët Françeskaj Shkollat Shqyptare	„ 221
4. Vepra Kulturele e Elementit Katolik në Shqypni	„ 234
5. Pellasgë e Heleenë	„ 262
6. Nata e Qirit (<i>Novelë Historike</i>)	„ 272
7. Rivista e Shtypit	„ 288
8. Quo Vadis...? — 17-18.	„ 129-137

Kuptimi shkolluer nder Kombe të qytetnueme

Nder të gjitha kombet e nder të gjitha kohët është njoftë e çmue randsija e edukatës e e arsimit.

Shkolla e arsimit është marrë në kujdes jo vetem prej qeverrive, por edhe prej inicjativave private, të cillat kanë bërë për me e binarizue ket forcë të kombit, që është djelm-nija. Këndeje nevoja e njëj sistemi shkolluer. E që, giatë historís së legjislaturës shkollore, na paraqiten *ligjë, dekrete, rregullore, urdhna, çarkore* etj., të cillat kanë pasë qellim kryesuer vetem e vetem edukaten e fëmijvet. Mbas sá provësh të bërë e mbas sa fazesh të ndryshme që muer arsimit botnuer giatë historís së vet, që se si rezultati i kësajë eksperjence disá herësh sbekullore gjindet sot i kristalizuem nder kombe më të qytetnueme.

ANGLIJA

Konstitucjoni i Anglís nuk përmban kurrnjí dispozicjón shkolluer. Anglija deri më sot nuk ká pasë kurrnjí ligjë organike për shkolla të mesme e Universitete. Kto janë këndë e janë të pamvarshme prej shtetit e gzojnë një autonomí të plotë administrative, didaktike e dishiplinore. Çdo personë a institut privat mund të çilin shkolla të mesme e Universitete, mund t' emnojnë profesora, mund të japin diploma me tituj ligjorë, etj. pá këndë t' auktorizuem e të kontroluem prej Shtetit.

Per shka u perket shkollave fillore, në vjetë 1870 ndeshim mâ të paren ligjë organike, e cilla thirret edhe ligja Forster e pat per qellim me u ndimue shkollave fillore private tue çilë shkolla nder ato vende kû mungojshin.

Vetem në vjetë 1870 shofim arsimin filluer t' Anglís të dâm në dy kategori: *shkolla zyrtare*, (Board schools) e *shkolla të lira* (voluntary schools). Në themel të kësajë ligje shkollat e lira mujshin me u' mbajtë autonome, ase mujshin edhe me kerkue qi t' u njifshin prej shtetit si shkollë private publike e kështu me i u dhânë tagri nder subvencjone të shtetit. Në ket rasë ligja e 1870 (art. 7) u vû shkollave të lira qi dishrojsin me u deklarue publike nji klausula (Conscience Clause), mbas së cillës Shteti kerkon:

1) me pranue në shkollë të gjith fëmijt qi dishrojn me u shkruue, pá ndryshim besimit;

2) me lânë të lirë fëmijt prej besimit në rasë qi dishrojn prindja;

3) mos me i detyrue në sjellje fetare si mbrenda si jashta shkollat, kuer mos të duen prindja e tyne;

4) mos me detyrue fëmijt e besimeve tjera me bâ mësim nder festa t' Urdhnueme etj.

Në vjetë 1902 kemi nji ligjë të dytë n' Anglí votue me 2 Dhetuer t' atij vjeti. Per shka i perket mësimt të besimit, nuk u bâ mâ i vogli ndryshim.

Q' at herë e at herë shkollat e lira publike u vûne drejt per së drejti nen organizimin arsimuer të shtetit me personal, administratë e rregullore të veten, e u kjenë dhânë të njajtat tagre sikuerse shkollave zyrtare e kështu Anglikant e Katolikët në ket vjetë fituene të drejten në barasimin financjâr të buxhetit t' Arsimit.

Me 8 Gusht 1918 Anglija bâni disá permirsime në sistemin sholluer perpá cene shkollat e lira e tagrin e mësimt të besimit. Me ket metodë Anglija vepron edhe sot.

